



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 737/13 Prot.

Vlorë më, 26.03.2024

VENDIM
Nr. 14, datë 25.03.2024

PËR
ÇELJEN E PROCEDURAVE PËR NGRTJEN E KOMSIONIT TË APELIMIT NË UV

Në zbatim të nenit 131 të Ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Urdhrit të MAS, Nr.101, date 13.03.2024 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë", të Urdhrit të Rektorit të UV, Nr.48 , datë 19. 03. 2024 "Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, Senati Akademik në mbledhjen e datës 25.03.2024,

VENDOSI:

1. Të miratojë çeljen e procedurave për ngritjen e Komisionit të Apelimit në UV.
2. Të miratojë përbërjen e Komisionit të Apelit i përbërë nga 5 (pesë) anëtarë, personel akademik, të paktën nga një për çdo fakultet. Në rast se nuk ka kandidatë të paraqitur nga një fakultet, atëhere vijon lista më poshtë.
3. Të miratojë çeljen e procedurës për vetëkandidim për anëtarë të Apelimit të UV si dhe njoftimin zyrtar me kriteret përkatëse, drejtuar personelit akademik, në funksion të regjistrimit për vetëkandidim, bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Të miratojë periudhën kohore të pranimit të vetëkandidimeve e cila zgjat 5 (pesë) ditë pune, duke filluar nga data e nënshkrimit dhe shpalljes nga Kryetari i SA të këtij vendimi.
5. Vetëkandidimet dorëzohen në Zyrën e Arkivit Qëndror të UV-së dhe administrohen nga sekretaria e SA.
6. Vendimi shpallet në web-in e UV-së dhe i bëhet me dije personelit akademik, drejtuesve të njësive bazë dhe kryesore, si dhe Këshillit Studentor të UV, për njohje dhe zbatim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof.As. Xhiliola AGARAJ (SHEHU)

